



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/37

Datë: 15.09.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 34, 35 dhe 36 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/37

Datë: 15.09.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2011, mori

V E N D I M

1. Për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), ndahen mjete financiare për vitin 2011 në vlerë prej 40.000 (dyzetmijë) euro.
2. Shuma në vlerën e sipërpërmendur formalisht është vendosur në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Bukuresht, në nëntor të vitit 2006, në bazë të kontributit të dakorduar vjetor, varësisht prej grupit (Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej 4 % të shumës totale) të vendeve të Evropës Juglindore.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/37

Datë: 15.09.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2011, mori

V E N D I M

1. Paga e Koordinatorit për të Drejtat Pronësore, të emëruar me vendim të Kryeministrit nr.062 të datës 12.08.2011, caktohet në vlerë prej 577.50 (pesëqindeshtatëdhjeteshtatë euro e pesëdhjetë cent) bruto në muaj.
2. Mjetet financiare në shumë prej 2,423.40 (dymijekatërqindnjëzetetë euro e dyzetë cent) për pagën e të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi deri në dhjetor 2011, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, kodi 10700.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e vendimit
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/37

Datë: 15.09.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2011, mori

V E N D I M

Për fushëveprimin, përbërjen dhe funksionimin e Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (KKPEPF)

Neni 1
Fushëveprimi i KKPEPF

Komiteti i Kosovës ka rolin që të vendosë politikat dhe prioritetet programore për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës, të monitoroj situatën e punës së fëmijëve në vend dhe të koordinoj veprimet kundër saj.

Neni 2
Funksionet e KKPEPF

Komiteti i Kosovës ka funksionet si në vijim:

1. Të japë udhëzime mbi politikat dhe programet që synojnë eliminimin e punës së fëmijëve dhe të përcaktoj fushat prioritare për programe të drejtpërdrejta që synojnë tërheqjen e menjëhershme të fëmijëve të përfshirë në format më të rrezikshme të punës dhe parandalimin e përfshirjes së fëmijëve të rrezikuar;
2. Të monitorojë situatën e punës së fëmijëve në vend dhe të koordinojë veprimet kundër saj;
3. Të bëjë propozime për të modifikuar dhe kompletuar legjislacionin mbi eliminimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve;

4. Të kërkojë përkrahjen e nevojshme nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë, e në veçanti nga Programi Ndërkombëtar i ONP-së mbi Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe të siguroj integrimin e intervenimeve të suksesshme në angazhimet qeveritare për luftimin e punës së fëmijëve;
5. Të përkrahë Qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera përgjegjëse në përmbushjen e objektivave dhe caqeve të përcaktuara me standardet dhe konventat e BE-së dhe ONP-se në fushën e punës së fëmijëve.

Neni 3 **Përbërja e KKPEPF**

1. Komiteti i Kosovës ka Kryetarin, nënkryetarin dhe 17 anëtarë të rregullt.
2. Anëtarë të rregullt të Komitetit të Kosovës janë përfaqësuesit e këtyre institucioneve:
 - 2.1. Një anëtar nga Zyra për Qeverisje të Mirë-ZKM
 - 2.2. Një anëtar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 2.3. Një anëtar nga Ministria e Financave;
 - 2.4. Një anëtar nga Ministria e Drejtësisë;
 - 2.5. Një anëtar nga Ministria e Punëve të Brendshme;
 - 2.6. Një anëtar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - 2.7. Një anëtar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 2.8. Një anëtar nga Instituti i Shëndetit Publik
 - 2.9. Një anëtar nga Ministria e Shëndetësisë;
 - 2.10. Një anëtar nga Departamenti i Punës-MPMS
 - 2.11. Një anëtar nga Departamenti i Mirëqenies Sociale-MPMS
 - 2.12. Një anëtar nga Instituti i Politikave Sociale -MPMS
 - 2.13. Një anëtar nga Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës-MPMS
 - 2.14. Një anëtar nga Policia e Kosovës - Komunitet
 - 2.15. Një përfaqësues nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës;
 - 2.16. Një përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës;
 - 2.17. Një përfaqësues nga Organizatat joqeveritare të përfaqësuara në Forumin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve;
3. Ministrinë në Komitetin e Kosovës përfaqësohen nga drejtorët e Departamenteve apo Udhëheqësit e Divizioneve.
4. Kryetari i Komitetit të Kosovës është Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
5. Nënkryetar i Komitetit të Kosovës është Drejtori i IPS-MPMS

Neni 4 **Mandati i anëtarëve të KKPEPF**

1. Anëtarët e Komitetit të Kosovës caktohen për periudhë katërvjeçare.

2. Anëtarët e KKPEPF mund të rizgjidhen më së shumti për dy mandate.
3. Kryetari dhe anëtarët nuk marrin asnjë pagesë për aktivitetin e tyre në Komitet.
4. Anëtarët e KKPEPF, nëse tri herë radhazi nuk marrin pjesë në takimet e rregullta të Komitetit, do të zëvendësohen me anëtarë të ri.

Neni 5 Format e punës së KKPEPF

1. Komiteti Kosovës mbledhet çdo katër muaj në takimet e zakonshme apo më shpesh në formë të takimeve të jashtëzakonshme, nëse inicohet kërkesa nga anëtarët apo në rast se takimet thirren nga Kryetari.
2. Komiteti i Kosovës merr vendime me votimin e së paku një e më tepër se gjysma e anëtarëve të KKPEPF.
3. Komiteti i Kosovës mund të themelojë nënkomitete të specializuara për fusha të ndryshme, si dhe Grupe punuese për ekzekutimin e vendimeve dhe realizimin e detyrave programore.

Neni 6 Pjesëmarrja e përfaqësuesve tjerë në takimet e KKPEPF

1. Përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme apo organizatave mund të asistojnë në takimet e Komitetit të Kosovës sipas rregullave të organizimit dhe funksionimit të takimeve të këti organi.
2. Komiteti i Kosovës mund të ftojë në takimet e veta përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, sindikatat e punëtorëve, administratën publike lokale, kanalet audio-vizuale dhe përfaqësues tjerë të shtypit të shkruar, si dhe universitetet, institutet e hulumtimit, organizatat ndërkombëtare apo personat të cilët përmes aktivitetit të tyre mund të lidhen me aktivitete për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve.
3. Përfaqësuesit e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe në rast nevojë ekspertë nga institucione të tjera, do të vijojnë takimet e Komitetit të Kosovës në funksionin e këshilluesit.
4. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Komiteti i Kosovës mund të kërkojë këshillim nga ONP, UNICEF apo nga organizata të tjera ndërkombëtare.

Neni 7 Sekretaria e KKPEPF

1. Komiteti i Kosovës ka një sekretari e cila siguron realizimin e aktiviteteve të përditshme dhe vepron në emër të Komitetit.

2. Sekretaria e Komitetit të Kosovës vepron në kuadër të njësisë së punës në IPS-MPMS.

Neni 8 **Mënyra e raportimit**

1. Njësia e Punës së Fëmijëve duhet t'i prezantoj Komitetit Kosovar mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve raportet vjetore mbi aktivitetet e realizuara për parandalimin dhe eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve, bazuar në raportet e përgatitura nga institucionet anëtare.
2. Raporti i definuar sipas paragrafit (1) i dorëzohet Komitetit Ndërmnistror për Mbrojtjen e Fëmijëve, respektivisht Kryeministrit të Kosovës nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 9 **Hyrja në Fuqi**

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë